



**ALBANIAN UNIVERSITY**  
UNIVERSITAS - FABREFACTA - OPTIME

**DEPARTAMENTI I STOMATOLOGJISË:**

1. Në periudhën 12-13 tetor 2018, është mbajtur Kongresi i Gjashtë Mbarëshqiptar i Stomatologjisë, bashkëpunim i Shoqatës së Stomatologëve Shqiptarë me Fakultetin e Shkencave Mjekësore, Albanian University, shprehur në numër të konsiderueshëm referimesh dhe moderimesh nga stafi efektiv i Departamentit të Stomatologjisë.
2. Në datat 9-10 Nëntor 2018, do të organizohet Kongresi i 2-të i Fakultetit të Mjekësisë Dentare me temë: "Qasje të reja interdisiplinare në reabilitimin oral dhe të përgjithshëm", një bashkëpunim i FMD dhe Fakultetit të Shkencave Mjekësore, Albanian University.
3. Në muajin Mars 2019 do të zhvillohet Konferenca e 13 Shkencore Studentore, me pjesëmarrjen e studentëve dhe pedagogëve të fushave përkatëse, si udhëheqës. Në këtë Konferencë do të prezantohen edhe disa nga punimet shkencore të Temave të Diplomave për vitin akademik 2018-2019, ku do të vlerësohet edhe Tema më e mirë me anë të një çmimi.
4. Në periudhën 9-11 Maj 2019, do të organizohet Kongresi i 24-t i Shoqatës Ballkanike Stomatologjike BaSS 24, bashkëpunim i FMD dhe Fakultetit të Shkencave Mjekësore, Albanian University.
5. Viti akademik 2018-2019, është një vit jubilar përse i përket Konferencës Vjetore Stomatologjike. Si Departament shënojmë 15 vite eksperiencë, në organizimin me sukses të Konferencave Ndërkombëtare, në fushën e stomatologjisë, të cilat tashmë janë kthyer në aktivitete të mirëfillta shkencore. Qëllimi i tyre është mbledhja dhe shkëmbimi i eksperiencave të lektorëve vendas dhe të huaj, që këtë vit do të kulmojnë me realizimin e Konferencës së 15-të Ndërkombëtare Stomatologjike në bashkëpunim me SENAME (Implant Association) në muajin Qershor 2019. Parashikojmë një organizim prestigjioz, të denjë për këtë vit jubilar.
6. Parashikojmë zhvillimin e leksioneve të hapura organizuar nga Departamenti i Stomatologjisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Albanian University (1 leksion në çdo 3 muaj).
7. Klinika Universitare dhe Programi i Studimit të Specializimeve, do të organizojnë Work-Shop-e mbi "Kirurgjinë Implantare", të cilat do të zhvillohen, sipas kalendarit të mëposhtëm:
  - 11-12-13 Tetor 2018 - workshop "Implantologjia Bazike", Fabio de Propri, Erda Qorri



**ALBANIAN UNIVERSITY**  
UNIVERSITAS - FABREFACTA - OPTIME

- 18-19-20 Tetor 2018 - workshop “Split crest në Implantologji”, Fabio de Propriis, Erda Qorri
- 2-3 Nëntor 2018 - workshop “Implanto-protesa” Malagutti -Qorri
- 15,16,17 Nëntor 2018 - workshop “Sinus lifting”, Fabio de Propriis, Erda Qorri
- 20,21, 22 Dhjetor 2018 - workshop “Toronto bridge, all on four”, Fabio de Propriis, Erda Qorri
- 17,18,19 Janar 2019 - workshop “Protokolli i menaxhimit dhe mirëmbajtjes së protezave mbi implante”, Fabio de Propriis, Erda Qorri
- 14,15,16 Shkurt 2019 - workshop “Kirurgjia e molarëve të tretë”, Fabio de Propriis, Erda Qorri
- 11,12,13 Prill 2019 - workshop “Kirurgjia Endodontike”
- 16,17,18 Maj 2019 - workshop “Kirurgjia Rigjenerative, A- Prf, I -Prf” .

**DEPARTAMENTI I FARMACISË**

Për vitin akademik 2018-2019, Departamenti i Farmacisë në bashkëpunim me pedagogë të angazhuar në mësimdhënie në Departamentin e Farmacisë si dhe specialistë të fushës ka parashikuar të zhvillojë aktivitet shkencore përgjatë gjithë vitit akademik 2018-2019, në funksion të edukimit në vazhdim të farmacistëve të diplomuar në programin studimi i integruar Master i Shkencave në “Farmaci”, por jo vetëm: departamenti do të organizojë dhe leksione të hapura për Studentë që aktualisht ndjekin studimet si dhe një Konferencë Kombëtare/Ndërkombëtare vjetore të organizuar në rang Departamenti.:

Për vitin akademik 2018-2019, Departamenti i Farmacisë planifikon të zhvillojë Konferencën e IX studentore në bashkëpunim me studentët dhe pedagogët e disiplinave të ndryshme. Tematikat synojnë të vendosin në fokus rritje shkencore që ndeshen në të gjitha disiplinat e formimit profesional të farmacistit, ku mund të veçojmë: teknologjia e përgatitjes së barnave, kontrolli i cilësisë së barnave, analiza e lëndëve helmuese (analiza toksikologjike), kontrolli i cilësisë së bimëve mjekësore e aromatike etj.



**ALBANIAN UNIVERSITY**  
UNIVERSITAS - FABREFACTA - OPTIME

Për vitin akademik 2018-2019, Departamenti i Farmacisë planifikon të zhvillojë në Konferencën e V- të Ndërkombëtare .Kjo konferencë do të zhvillohet në bashkëpunim me Urdhërin e Farmacistit të Shqipërisë, Universitetin e Studimeve të Pizës, Itali dhe Universitetin e Studimeve të Napolit “ Federico II” Itali. Në këtë konferencë, do të paraqiten risitë inovative të kërkimit shkencor te zhvilluar në Itali dhe Shqipëri; këto punime do të referohen nga Profesore të shquar të Universiteteve partnere Italiane dhe nga Profesore te shquar të fushës akademike shqiptare dhe stafit akademik të Albanian University. Konferenca do të zhvillohet në ambientet e Tirana International Hotel & Conference Center .

Në këtë Konferencë do të prezantohen punime të mirfillta shkencore të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor, të cilat do të botohen në librin e abstrakteve, si dhe në një numër special botimi të revistës Optime të Albanian University.

\* Për vitin akademik 2018-2019, Departamenti Farmacisë planifikon të zhvillojë nga periudha Dhjetor 2018 -Qershor 2019, disa leksione të hapura me pjesëmarrjen e profesorëve të Universiteteve partnere, apo të Albanian University.



**ALBANIAN UNIVERSITY**  
UNIVERSITAS - FABREFACTA - OPTIME

**DEPARTAMENTI I INFERMIERISË DHE FIZIOTERAPISË**

**Veprimtaria kërkimore të parashikuara:**

1. Për vitin akademik 2018-2019, Departamenti i Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë gjatë muajve **janar-shkurt 2019**, do të zhvillojë një Leksionin e hapur në bashkëpunim me studentët e programeve të studimit, Infermieri, dhe Master Profesional Infermieri Kirurgikale, me pjesëmarrjen e pedagogeve të disiplinave të ndryshme. Tematika e leksionit të hapur, do të sjellë në fokus risitë shkencore në fushën e Infermierisë, si pjesë e rëndësishme e formimit profesional të Infermierit.

2. Për vitin akademik 2018-2019, Departamenti i Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë në bashkëpunim me Departamentin e Stomatologjisë dhe Departamentin e Farmacisë do të organizojë në periudhë **shkurt-mars 2019** Konferencën Studentore në Albanian University. Në këtë konferencë, studentë paraqesin një dizertacion kërkimor shkencor të mbështetur nga pedagogë të Albanian University përpara një komisioni dhe përpara studentëve.

Puna kërkimore e vlerësuar si më e mira në këtë konferencë studentore, i jepet drejta që të prezantohet në konferencën në rang Departamenti. Ky fakt, për të promovuar dhe stimuluar kërkimin shkencor tek studentët e Albanian University.

3. Për vitin akademik 2018-2019, si çdo vit, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë planifikon të organizojë në muajin **Prill 2019**, Konferencën Shkencore Kombëtare/Ndërkombëtare me pjesëmarrje të Profesorëve të angazhuar në Albanian University, si dhe profesionistë dhe ekspertë të fushave të ndryshme të shëndetësisë dhe me një aktivitet të pasur kërkimor shkencor shqiptarë dhe të huaj. Konferenca do të jetë e



**ALBANIAN UNIVERSITY**  
UNIVERSITAS - FABREFACTA - OPTIME

drejtuar jo vetëm profesionistëve por dhe studentëve të infermierisë dhe fizioterapisë, si dhe masterave profesionale, duke pritur një pjesëmarrje të gjerë.

4. Për vitin akademik 2018-2019, Departamenti i Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë gjatë muajit **Maj 2019**, do të zhvillojë një Leksionin e hapur në bashkëpunim me studentët e programeve të studimit Fizioterapi dhe master profesional Terapi Manuale, me pjesëmarrjen e pedagogeve të disiplinave të ndryshme. Tematika e leksionit të hapur, do të sjellë në fokus risitë shkencore në fushën e Fizioterapisë dhe Terapisë Manuale si pjesë e rëndësishme e formimit profesional të Fizioterapistit.